


# TË LUFTOSH DISINFORMIMIN RUS, PAS PUSHTIMIT TË UKRAINËS







“Në luftë, e vërteta është viktima e parë.”

**Eskili**

## KONTEKSTI



**K**emi dëshmuar në kohë reale se si dezinformimi mund të ndikojë perceptimet ndaj luftës dhe konflikteve me pushtimin e Rusisë në Ukrainë në shkurt të vitit 2022. Fillimisht, me aneksimin e Krimesë në vitin 2014, Rusia ka përdorur instrumentet e saj mediatike për të përhapur disinformim me qëllim prezantimin e veprimeve të kryera në Ukrainë në favor të saj dhe për të ulur besimin te mediat dhe qeveritë perëndimore. Rusia, përmes disinformimit të saj, ka synuar të arrijë të fushatat zgjedhore në të gjithë botën dhe tani po përpiqet të krijojë opinionin publik mbi arsyet se pse e pushtoi Ukrainën. NATO ka përcaktuar narrativat e disinformimit që Rusia po përdor për të justifikuar veprimet e saj, duke përfshirë pretendimet se NATO është në luftë me Rusinë, se Aleanca i kishte premtuar Rusisë se nuk do të zgjerohej pas Luftës së Ftohtë dhe që rrjedhimisht nuk do ta rrethonte territorin e saj, si dhe që NATO dhe lëvizjet e saj janë agresive dhe kërcënuese për Rusinë. Shumë nga këto narrativa kanë arritur në mediat shqiptare, siç do t'i shpjegojmë më poshtë.

Lidhjet kulturore, politike dhe sociale të Ballkanit Perëndimor me Rusinë e kanë bërë rajonin terren pjellor për përhapjen e disinformimit rus. Siç argumentohet në raportin e Qendrës së Komunikimeve Strategjike të NATO-s, “Rusia e sheh Ballkanin Perëndimor si një mundësi për të nënvlerësuar BE-në dhe NATO-n duke përdorur pikat e dobëta të vendeve të këtij rajoni.” Në përhapjen e disinformimit ndaj BE-së dhe NATO-s, Rusia përpiqet të dobësojë besimin në këto institucione dhe të paralizojë zgjerimin e tyre. Lufta në Ukrainë i ka dhënë Rusisë mundësinë që këto narrativa të përhapen, duke përdorur pasigurinë dhe dëshirën e publikut për informacion.

Në kontekstin e luftërave dhe konflikteve, propaganda gjithmonë ka luajtur një rol kyç në zhvillimin e luftës, pasi subjektet shtetërore dhe

jo-shtetërore të përfshira në të kërkojnë të krijojnë mbështetje për të justifikuar veprimet e tyre, për t'i penguar të tjerët të përfshihen në konflikt dhe për ta mbajtur popullsinë nën kontroll.

Raportimi i luftërave dhe konflikteve kërkon vërtetësi, balancë dhe paanshmëri, por janë pikërisht këto cilësi të rëndësishme që vështirë se gjenden në kohërat e sotme. Në fakt, fabrikimi i informacionit nuk është diçka e re. “Përdorimi i propagandës është i kahershëm, por kurrë më parë nuk ka pasur teknologji për ta përhapur atë në mënyrë kaq efektive”, argumentoi kolumnistja e Guardian, Natalie Nougayrède.

“Çrregullimi i informacionit” i shekullit të 21 është ndikuar gjerësisht nga përdorimi i teknologjisë dhe nga një numër i pakufizuar platformash përmes të cilave informacioni përhapet në kohë reale. Lufta bashkëkohore ka një dimension të komplikuar shtesë: jo vetëm që transmetohet në televizion, por ndahet dhe përjetohet online në kohë reale gjithnjë e më shumë.

Në momente konflikti dhe pasigurie, miliona njerëz kërkojnë informacion në internet (dhe gjithnjë e më shumë në media sociale). Nevoja për lajme dhe informacion në momente të caktuara shpesh përplasat me aftësinë e gazetarëve dhe mediave të besueshme me reputacion, të cilët kanë nevojë për kohë dhe përpjekje për të verifikuar faktet me shpejtësi dhe në situata të paparashikueshme. Ky tension midis dëshirës për informacion të menjëhershëm dhe realitetit të nevojshëm për të dhënë një informacion të saktë ka qenë veçoria karakteristike e peizazhit mediatik të sotëm, e theksuar veçanërisht në momente konflikti dhe në zonat e luftës.

Në Ballkanin Perëndimor, studimet kanë treguar se aktorët e huaj janë lojtarët e pakicës në lojën e disinformimit. Shumica e krijuesve dhe shpërndarësve të disinformimit në këtë rajon janë vendas dhe kanë qëllime lokale.

Shpeshherë Shqipëria është parë si një nga vendet më pak të prekura nga propaganda ruse. Në përgjithësi, anketat për vulnerabilitetin e vendit ndaj ndikimit të dëmshëm të huaj në media kanë nxjerrë si konkluzion se disinformimi në Shqipëri është çështje e brendshme. Megjithatë, lufta në Ukrainë ka treguar se Shqipëria është ende e ekspozuar ndaj propagandës ruse dhe nuk është imune kundër saj. Portale dhe faqe

të caktuara në Facebook publikojnë rregullisht propagandën dhe disinformimin rus, ndërsa media të tjera përhapin disinformim duke raportuar deklarata të politikanëve dhe mediave ruse pa dhënë kontekst, ose pa i hedhur poshtë pretendimet. Raporti i fundit i Balkan Investigative Network ka zbuluar se 88 narrativat e disinformimit të identifikuara nga baza e të dhënave EUvsDisinfo u paraqitën në median shqiptare, rreth 22% e bazës më të madhe të të dhënave. Studiuesit arritën të gjejnë rreth 377 artikuj në median shqiptare që përmbanin disinformim rus. Këto rezultate konfirmojnë studimet e dy viteve të fundit të Fakteje-s mbi narrativat e përhapura në median shqiptare, veçanërisht ato që lidhen me mbulimin e luftës në Ukrainë. Fakteje ka publikuar të paktën 200 verifikime të lidhura me narrativat e disinformimit në Ukrainë. Verifikimi i parë daton në shkurt të vitit 2022 dhe lidhet me pretendimin e Ministrit të Jashtëm të Rusisë, Lavrov, se mercenarë nga Shqipëria dhe shtetet e tjera të Ballkanit po dërgohen në Ukrainë për të luftuar kundër Rusisë.

Përveç disinformimit rreth luftës në Ukrainë, Shqipëria është veçanërisht e ndjeshme ndaj disinformimit për konfliktin midis Serbisë dhe Kosovës, sidomos ndaj narrativave që parashikojnë një luftë midis dy vendeve ose që presin një tjetër luftë në Ballkanin Perëndimor. Sa herë që tensionet përshkallëzohen në veri të Kosovës ose përpjekjet për dialog ngecin, mediat shqiptare raportojnë frikën për një luftë të re, duke ngritur pretendime mbi ushtrinë serbe në kufi. Frikërat ushqehen më tej nga deklaratat e politikanëve që ndezin zjarrin e një lufte të mundshme, të cilat mediat shqiptare i ripublikojnë pa konfirmim ose pa kontekst. Po ashtu, interesat strategjike të Rusisë në Ballkanin Perëndimor nënkuptojnë interesin e vendit ndaj përkeqësimit të konflikteve lokale për rritjen e paqëndrueshmërisë, ndërsa narrativat që i shërbejnë synimeve të Rusisë vetëm përkeqësojnë konfliktet etnike në një cikël që vetëmbahet.

Raportimet për luftën dhe konfliktin kërkojnë ndërgjegjësim të rritur për mënyrën se si aktorët, si shtetërorë ashtu edhe jo-shtetërorë, e përdorin disinformimin dhe propagandën për të krijuar opinionin publik. Saktësia është e domosdoshme kur bëhet fjalë për situata me rëndësi, sidomos në kontekstin e konflikteve rajonale në Ballkanin Perëndimor, që mund të përhapin konflikte etnike dhe të përmbushin synimet e vendeve si Rusia. Narrativat mund të ndikojnë opinionin publik, të ulin besimin te proceset demokratike, si dhe te BE-ja e NATO. Për ta luftuar këtë fenomen që

po ndodh tashmë në mediat shqiptare në lidhje me luftën në Ukrainë dhe me Serbinë-Kosovën do të nevojiten gazetarë të përgjegjshëm që mbështeten mbi kërkime të thelluara dhe përpjekje të vazhdueshme për verifikimin e fakteve.

## **Çfarë është disinformimi?**

Disinformimi është informacion i rremë ose i pasaktë që një aktor dashakeqës përdor me qëllim të qartë për të mashtruar njerëzit (Lazer et al., 2018). Bashkimi Evropian e përkufizon disinformimin si informacion të rremë ose të gabuar që mund të verifikohet, i krijuar, paraqitur dhe përhapur për përfitime ekonomike ose për të mashtruar qëllimisht publikun, dhe i cili “mund të shkaktojë dëme publike dhe kërcënime për proceset demokratike politike dhe të vendimmarrjes, si dhe për të mirat publike”.

Ndaj, disinformimi ndryshon nga keqinformimi (shpërndarja e thjeshtë e informacionit të rremë) ose informimi i rremë (shpërndarja e dëmshme e informacionit të vërtetë, duke përfshirë rrjedhjet). Të trija këto forma përfaqësojnë largim nga praktikat “normale” të komunikimit masiv, pasi gjeneruesi i tyre shkel besimin duke krijuar diçka që shpesh quhet «lajm i rremë». Gabimi themelor në disinformim mund të ketë një ose më shumë forma. Zakonisht, disinformimi synon të nxisë një emocion specifik të fortë (zemërim, frikë, neveri) dhe të anashkalojë mendimin racional dhe kritik mbi objektivin e synuar.

Lajmet e rreme përkufizohen si “artikuj lajmesh të krijuar qëllimisht për të qenë të rremë, vërtetësia e të cilëve është e verifikueshme dhe që mund të keqinformojnë lexuesit” (Allcott & Gentzkow, 2017). Verifikuesit e fakteve e përdorin këtë term në kuptimin e një “njësie përmbajtjeje” - tekst, foto ose video që prezantohet në formën e një historie lajmi ose si një postim në media sociale. Në këtë kontekst, duhet të trajtojmë konceptin e burimit të rremë - kur informacioni i atribuohet një burimi të njohur, por në fakt është i rremë - dhe kontekstin e rremë - interpretimin e pasaktë ose kontekstet fiktive.

“Disinformimi” është vetëm një element i një grupi më të gjerë aktivitetesh informative armiqësore që mund të përfshijnë shumë taktika, teknika dhe procedura.

Konceptet dhe termat kyçe lidhur me disinformimin gjatë kohërave të luftës dhe konflikteve janë:

**Disinformimi** - informacion i rremë ose i pasaktë që përhapet qëllimisht për të manipuluar mendimet dhe veprimet e të tjerëve.

**Keqinformimi** - informacion i rremë ose i pasaktë që përhapet pa qëllim të keq, ndonëse efektet e tij mund të jenë të dëmshme.

**Propaganda** - informacion i projektuar për të manipuluar një audiencë të caktuar në lidhje me një sjellje ose besim të veçantë, shpesh si pjesë e një fushate të tejzgjatur nga një aktor shtetëror me axhendë politike.

**Narrativa armiqësore** - një histori specifike e krijuar për të diskredituar ose për të shpifur për një objektivi të caktuar.

**Aktivitete informative armiqësore** - një diapazon i gjerë veprimesh të koordinuara të projektuara për të mbjellë dyshime dhe për të manipuluar opinionin,

zakonisht duke përfshirë një ose të gjitha metodat dhe teknikat e mësipërme, si meme keqorientuese, teori konspirative, imazhe ose video të rreme, citime të nxjerra jashtë kontekstit, ose thjesht gënjeshtër që njerëzit i thonë për të manipuluar të tjerët

**Lufta hibride** - përdorimi i mënyrave ushtarake dhe joushtarake, si dhe i mjeteve të fshehta dhe të hapura (përfshirë disinformimin, sulmet kibernetike, presionin ekonomik, përdorimin e grupeve të armatosura të rregullta dhe përdorimin e forcave të rregullta) për të sfumuar vijat mes luftës dhe paqes, për të mbjellë dyshime në mendjet e popullatës objektivi, si dhe për të destabilizuar e për të zbehur shoqëritë.

## **Efektet e disinformimit**

Disinformimi shkatërron besimin e njerëzve tek burimet tradicionale të lajmeve - të cilat, në kundërshtim me agjentët e disinformimit, kanë standarde etike dhe përgjegjësi ligjore në raportimin e fakteve, e që shpesh janë më komplekse dhe më pak të kënaqshme se narrativat e thjeshta armiqësore.



Ai shkatërron besimin e njerëzve të qeveritë dhe institucionet e tjera publike. Disinformim shpesh synon të nxisë impulset më të këqija, frikërat dhe paragjykimet tona, duke krijuar konflikte mes grupeve sociale, duke pranuar si të vlefshëm dhe duke nxitur ekstremizmin, duke zvogëluar ndjenjat tona të përkatësisë në një komunitet ose në një vend - të gjitha këto me qëllim për të përçarë dhe për të sunduar shoqërinë në betejën e informacionit.

Gjatë viteve të fundit, debati publik dhe politik për disinformimin është përqendruar të përpjekjet për ta përçarë politikën brenda dhe mes vendeve të treta. Kjo përkon, mbi të gjitha, me fushatat e disinformimit të lidhura me Rusinë të realizuara përmes kombinimit të kanaleve të hapura dhe të fshehura për të bindur audiencën të huaja dhe vendase mbi ide të caktuara. Në veçanti, në Ballkanin Perëndimor, operacionet e disinformimit të lidhura me Rusinë duket se janë të organizuara në shërbim të interesave jashtë-shtetërore, duke përfshirë ato të grupeve të organizuara kriminale e më gjerë për të diskredituar dhe për të dobësuar rolin global të BE-së dhe Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Në shumë vende, përfshirë edhe Shqipërinë, ka pasur nisma dhe hapa konkrete për ngritjen e komiteteve apo komisioneve për disinformimin. Shumica prej tyre janë përbërur me kritika, veçanërisht në lidhje me fushën e zbatimit, formimin, si dhe dyshimet mbi njëanshmërinë ose sugjerimin e ndërhyrje të panevojshme në lirinë e mediave. Disa prej tyre kanë qenë jetëshkurtër dhe janë ndërprerë<sup>1</sup>.

Në Shqipëri, ky komitet<sup>2</sup> u propozua në mars të vitit 2024 nga deputetët e partisë në pushtet dhe u miratua me votat e tyre në prill të vitit 2024. Studiuesit dhe organizatat që punojnë për zhvillimin e mediave në vend kanë shprehur shqetësime në lidhje me qartësinë dhe qëllimin e komisionit dhe kanë theksuar nevojën për transparencë duke kërkuar konsultime të detajuara për objektivat e komisionit dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

---

1. Shih më shumë këtu: <https://www.washingtonpost.com/technology/2022/05/18/disinformation-board-dhs-nina-jankowicz/>

2. Shih më shumë këtu: <https://www.reporter.al/2024/04/25/komisioni-i-dezinformimit-vigjilence-apo-kercenim-per-lirine-e-medias/>

Në luftën në Ukrainë, disinformimi dhe propaganda, bashkë me sulmet kibernetike, po shkaktojnë dëme të mëdha me efekte shkatërruese në opinionin publik. Lufta nuk po luftohet vetëm me raketa, bombat dhe tanke, por edhe duke përhapur lajme të rreme, viruse kompjuterike, disinformim dhe propagandë.

Disinformimi përhapet më shumë në ambiente që tashmë janë të përçara nga konflikte të brendshme, ku besimi shoqëror dhe publik kanë vështirësi të mblidhen për të bashkuar ndarjet politike, rajonale, etnike, fetare ose të tjera. Çrregullimi i informacionit - përfshirë disinformimin - është zakonisht simptomë e çrregullimeve shoqërore dhe politike, më shumë se sa shkak i tyre.

Shumë politikëbërës po përpiqen të gjejnë mënyra të shpejta dhe efektive për t'i ndaluar njerëzit të pranojnë dhe të përhapin besime të rreme që degradojnë diskursin demokratik dhe që mund të nxisin veprime të dhunshme. Megjithatë, disinformimi ka rezultuar të jetë i vështirë për t'u përkufizuar, kuptuar, vlerësuar dhe adresuar. Jetojmë në një kohë thjesht përcjellja e informacionit në hapësirën publike shpesh nuk sjell ndryshime. Pra, cili është roli i gazetarëve në sferën publike, në këtë peizazh të komplikuar politik dhe informativ?

Studiuesit dhe ekspertët po kërkojnë rishikimin e rolit dhe impaktit të gazetarisë në demokraci. “Ndërkohë që rritja e polarizimit dhe rëndësia e identifikimit të fakteve sfidojnë parimet gazetareske tradicionale, ne duhet të ndryshojmë mënyrën tonë të vepruarit, duke u fokusuar te ndërtimi i komuniteteve, teksa vazhdojmë të respektojmë etikën gazetareske” (Pomerantsev, 2024).

Në Shqipëri, disinformimi është tipar i përhapur i konkurrencës politike vendase, por përpjekjet janë përgjithësisht oportuniste dhe fushatat janë të shkurtra. Ka relativisht pak prova lidhur me përpjekjet e fuqive të huaja për të deformuar politikën shqiptare apo ngjarjet ndërkombëtare.

Afërsia me luftën/konfliktin justifikohet përmes informacionit që pretendon të lidhet me pjesëmarrjen e pretenduar shqiptare në këtë luftë. Rasti i mëposhtëm studimor i referohet mercenarëve nga Shqipëria që marrin pjesë në këtë konflikt dhe informacioni është klasifikuar si i rremë pas verifikimit nga Faktejo me burime zyrtare.

Në qershor të vitit 2022, Ambasada Ruse në Shqipëri publikoi një listë në të cilën njoftoi se 42 mercenarë nga Shqipëria ishin vrarë në Ukrainë, ndërsa pretendonte se rreth 150 mercenarë shqiptarë kanë qenë të pranishëm në Ukrainë që prej fillimit të luftës. Dokumenti i publikuar nga Ministria e Mbrojtjes Ruse përfshin statistika të disa vendeve, por nuk përmban informacion mbi mënyrën se si janë mbledhur këto të dhëna dhe burimet mbi të cilat janë bazuar.

Menjëherë pas publikimit, media shqiptare i ka shpërndarë gjerësisht këto numra, duke përdorur vetëm të dhënat dhe shifrat e deklaruara nga Ambasada Ruse në Tiranë. Disa media bashkuan numrin e pretenduar të shqiptarëve nga të dy vendet, Shqipëria dhe Kosova, duke publikuar artikuj ku numri i pretenduar i shqiptarëve të përfshirë në konfliktin Ukrainë-Rusi dukej edhe më i lartë.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e ka mohuar deklaratën e publikuar nga ambasada ruse, teksa rikonfirmonte qëndrimin e bërë publik nga Ministrija Xhaçka në mars të vitit 2022, kur u diskutua për herë të parë çështja e mercenarëve shqiptarë në Ukrainë. Në atë kohë, Ministrija shkroi: “Nuk ka mercenarë shqiptarë në Ukrainë! Kjo është një gënjeshtëri, që Moskë vazhdon ta përsërisë pa turp! Shqipëria është në anën e Ukrainës dhe do të vazhdojë të punojë me të gjitha aleatët dhe partnerët për të ndihmuar në përfundimin e agresionit të paporovokuar të Rusisë ndaj popullit të Ukrainës. Zoti i bekoftë.”

Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, e kontaktuar nga Fakteje, ka deklaruar:

“Shqipëria, si anëtare e NATO-s, solidarizohet me Ukrainën dhe do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në përfundimin e konfliktit të armatosur dhe sulmeve të nisura nga Rusia. Si çdo anëtar tjetër i NATO-s, Shqipëria nuk ka dërguar forca të armatosura në Ukrainë.”

<https://fakteje.al/debunking-42-nga-150-mercenare-shqiptare-jane-vrare-ne-ukraine-institucionet-zyrtare-deklarata-eshte-e-pavertete/>

## **Narrativat kryesore**

Narrativat janë një formë tregimi që ndihmojnë shpjegimin dhe krijimin e perceptimeve për një çështje të caktuar. Në thelb, ato janë histori të thjeshta të shkurtuara që i japin kuptim çështjeve më komplekse. Shpesh përfaqësojnë çështje të lidhura me identitetin, komunitetin dhe qëllimin.

Analiza e narrativave e bërë nga Fakte duke u bazuar te baza e të dhënave të saj për përgënjeshttrimet ka treguar një rritje të ndjeshme të përdorimit të një serie narrativash të rreme të lidhura me pushtimin e Ukrainës gjatë kohëve të fundit.

Studimi përfshiu analizën cilësore të përmbajtjes së 20 mediave shqiptare, kanaleve kryesore të lajmeve, portaleve me ndikim të rëndësishëm, dhe gazetave më të vogla tabloide. Studimi identifikoi mesatarisht 75 artikuj në muaj që përmbanin disinformim lidhur me çështjet e lartpërmendura, megjithatë artikujt përmbledheshin rreth një grupi bazë prej 5-7 narrativash, pasi shumë media kopjonin njëra-tjetrën dhe përhapnin pretendime të njëjta, shpesh herë fjalë për fjalë. Gjatë dy viteve të fundit, kemi publikuar më shumë se 150 artikuj që hedhin poshtë dhe përgënjeshtrojnë disinformime që vijnë nga Rusia dhe më tej, duke gjurmuar burimet dhe përhapjen e tyre në median shqiptare. Mes artikujve të identifikuar me forma disinformimi, narrativat më të zakonshme luftarake ishin si më poshtë:

- **Justifikimi i pushtimit të Rusisë në Ukrainë**
- **Përfshirja e NATO-s/SHBA-ve në Ukrainë**
- **Rusia do të fillojë Luftën e Tretë Botërore/Luftën Bërthamore**
- **Luftërat e vendeve të treta në Ballkanin Perëndimor**

### **a) Narrativa disinformuese për justifikimin e pushtimit të Rusisë në Ukrainë**

Pretendimet për justifikimin e pushtimit të Rusisë në Ukrainë kanë marrë forma të ndryshme. Në përgjithësi, Rusia ka tentuar të krijojë një aks të ri nëpërmjet të cilit ajo prezantohet si fuqia e mirë, ndërsa perëndimi dhe NATO si fuqia e keqe. Në këtë kontekst, një nga narrativat që ajo ka shfrytëzuar ishte se pushtimi i Ukrainës erdhi si shkak për shpëtimin

e ukrainasve që flasin ruisht nga “neo-nazistët”. Rusia pretendon se një grusht shteti në vitin 2014 solli në pushtet simpatizantë të nazizmit në Ukrainë dhe e bëri vendin më të afërt me Perëndimin. Rusia ka përdorur historinë e saj në Luftën e Dytë Botërore për ta paraqitur pushtimin si një akt lirie nga nazistët. Këto narrativa janë përhapur edhe nga mediat shqiptare, të cilat kanë publikuar artikuj me tituj që përputhen me narrativën ruse dhe përhapin disinformim: “Denazifikimi sipas Moskës: Do të duhen 25 vjet, punë e detyruar, të zhduket emri Ukrainë.” Rusia ka pretenduar gjithashtu se e ka pushtuar Ukrainën për ta mbrojtur veten nga zgjerimi i Perëndimit, i cili paraqitet si kërcënim jetik për Rusinë—ndonëse do të ishte më e qartë të thuhej se perëndimi është kërcënim për ambiciet perandorake të Ruisë.

**Rasti**

**Studimor 2:**

## **Kujdes nga propaganda triumfaliste ruse për aneksimin e 4 rajoneve në Ukrainë!**

Më 30 shtator, Presidenti rus Vladimir Putin njoftoi aneksimin e katër rajoneve që përbëjnë pjesën më të madhe të juglindjes së Ukrainës: Donetsk, Lugansk, Kherson dhe Zaporizhzhia. Raportimet e mediave ndërkombëtare, përfshirë disa media në Shqipëri “e shitën” këtë ngjarje si triumf të Ruisë dhe dështim të Perëndimit, specifikisht të NATO-s.

Megjithatë, analiza e Fakteve sjell disa të vërteta që propaganda ruse ka arritur t’u fshehë nga sytë e publikut që e marrin të mirëqenë faktin se katër rajonet ukrainase janë aneksuar në Rusi “me vullnetin e tyre të lirë”.

Në ditën e fundit të muajit, Putin nënshkroi dokumente përmes të cilave pretendon të marrë kontrollin e sovranitetit të 15% të territorit ukrainas, në atë që gazeta amerikane New York Times e quajti krijimin e “një realiteti paralel në të cilin Rusia pretendon të ushtrojë sovranitet mbi mijëra kilometra katrorë të territorit që ushtria e saj nuk e kontrollon në të vërtetë.” Pikërisht këtu qëndron absurditeti i këtij aneksimi, i cili erdhi pak ditë pas përfundimit të disa referendumeve të dyshimta që treguan mbështetjen për aneksimin në Rusi, duke i trajtuar ato sikur të ishin tashmë pjesë e territorit të kësaj të fundit: pavarësisht se sa dokumente nënshkruan Putin, ai nuk ka kontroll të plotë ushtarak mbi asnjë nga katër territoret dhe më tepër, në skenën ndërkombëtare; vetëm Koreja e Veriut e pranon aneksimin si legjitim.

Në përgjithësi, mediat shqiptare e paraqitën aneksimin me të njëjtin skepticism që prit nga qeveritë dhe mediat ndërkombëtare. Megjithatë, pati disa nga ata që i nxorën mesazhet e Putinit jashtë kontekstit, duke kështu përhapur propagandën ruse për ngjarjet në juglindjen e Ukrainës. Në rastin e gazetës Koha Jonë, shkruhet:

“Miq të nderuar, do të bëjmë gjithçka për të mbështetur vëllezërit dhe motrat tona në Zaporizhzhia dhe Kherson, në Donetsk dhe Luhansk. Do të bëjmë gjithçka për të ngritur nivelin e sigurisë në këto territore për këta njerëz. Do të bëjmë gjithçka për të rindërtuar ekonominë. Për të rindërtuar infrastrukturën, për të ndërtuar shkolla, institucione të reja, spitale” - tha Putin. “Jemi më të fortë sepse jemi së bashku. Ne kemi të vërtetën. Dhe e vërteta nënkupton fuqi. Baba do të thotë fitore. Fitorja është e jona,” tha Putin. Ai përsëriti se sot është një “ditë historike, dita e së vërtetës dhe e drejtësisë”. Ai akuzoi Ukrainën për “tentativa për të shuar” kulturën e popujve që jetojnë në rajonet e Luganskit dhe Donbasit. Presidenti rus shtoi se banorët në këto rajone “e kanë bërë këtë zgjedhje për të qenë me atdheun e tyre trashëgimtar” në të ashtuquajturat referendume. Ukraina dhe Perëndimi i kanë raportuar si të paligjshme. “Rusia jo vetëm që po hap dyert. Rusia po hap edhe zemrën. Mirë se vini në shtëpi,” tha Putin.

<https://faktoje.al/kujdes-nga-propaganda-triumfaliste-ruse-mbi-aneksimin-e-4-rajoneve-ne-ukraine/>

## **b) Përfshirja e NATO-s/SHBA-ve në Ukrainë**

Narrativat kundër Perëndimit kanë qenë në thelb të historive që Rusia po tregon lidhur me arsyen e saj për pushtimin e Ukrainës. Zgjerimi i NATO-s në ish Bllokun Lindor dhe mundësia e miratimit të anëtarësimit të Ukrainës në NATO është cituar nga qeveria ruse si motiv për veprimet e saj ushtarake. Në veçanti, Kremli ka përdorur narrativa sipas të cilave NATO ka nisur organizimin e veprimeve ushtarak kundër Rusisë dhe e përshkruan Aleancën si kërcënim ekzistencial për vendin. Narrativa kundër NATO-s ka vazhduar të theksohet përgjatë muajve dhe është përdorur për intensifikimin e veprimeve ushtarake në Ukrainë. Për më tepër, aparati mediatik rus dhe mbështetësit e tij shpesh e kanë përhapur disinformimin për përfshirjen e NATO-s në luftë, duke pretenduar se NATO e ka mbështetur Ukrainën në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke dërguar ushtarë në territorin e saj. Deklaratat e

qeverive dhe politikanëve përëndimorë për mbështetjen e NATO-s dhe Përëndimit ndaj Ukrainës janë përdorur për të përhapur informacion të pavërtetë, duke shkaktuar tensione dhe duke bërë kërcënime për përshkallëzim.

## Rasti

### Studimor 3

## NATO ka trupa në Ukrainë

Shqiptarët po përhapin pretendimet se Ministri i Jashtëm polak, Radoslav Sikorski, ka deklaruar se trupat e NATO-s janë tashmë të pranishme në Ukrainë. Deklarata u interpretua për të thënë se ushtria e NATO-s është tani e përfshirë drejtpërdrejt në luftën mes Rusisë dhe Ukrainës. Fillimisht, lajmi u përhap në mediat e huaja si British Sky News dhe pastaj u përkthye në shqip.

“Nuk është e qartë se në ç’kapacitet po përdoren ushtarët.” – shkruajnë mediat shqiptare, duke lënë të kuptohet se ushtarët e NATO-s janë tashmë të përfshirë dhe po luftojnë në Ukrainë. Deklarata u përsërit edhe në median ruse, e cila ka pretenduar prej shumë kohësh se trupat e NATO-s janë tashmë të përfshirë në luftë.

Megjithatë, pas një hetimi të hollësishëm, pretendimet e ministrit polak kanë qenë qartësisht të deformuara. Mediat polake përfshijnë transkriptimin e fjalimit të plotë dhe media të tjera që kanë përkthyer saktësisht lajmin. Deklarata e plotë tregon të vërtetën për trupat të cilëve iu referohej Sikorski. “Kjo nuk është për trupa që do të marrin pjesë aktive në operacione ushtarake, por për ushtarët që janë të angazhuar në trajnimin e ukrainasve në terren, si dhe në përdorimin e pajisjeve ushtarake,” – citohet të ketë thënë ministri Sikorski. Faktaje ka drejtuar një kërkesë për informacion tek NATO për pretendimin e ngritur nga disa media. Në përgjigjen e tij, një zyrtar i NATO-s e informoi Faktaje-n se aleanca po jep mbështetje të paprecedentë ushtarake për Ukrainën, e cila nisi në vitin 2014 pas aneksimit të Krimesë dhe u rrit edhe më shumë pas sulmit të Rusisë në Ukrainë. Narrativa e përfshirjes së NATO-s në luftën në Ukrainë është e rrezikshme, pasi shpesh është përdorur nga Rusia për të rritur kërcënimet e saj, nga shpallja e luftës kundër Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut deri te kërcënimet për luftë bërthamore.


<https://faktoje.al/nato-nuk-ka-derguar-trupa-per-te-luftuar-ne-ukraine/>

### Lajmi për vrasjen e Sekretarit Amerikan të Mbrojtjes, Lloyd Austin, në Kiev.

Një tjetër lajm i rremë ishte artikulli që raportonte se Sekretari Amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, ishte vrarë në Kiev më 3 janar. Verifikimi i detajuar tregoi se ai ishte shtruar në spital për shkak të gjendjes së tij shëndetësore emergjente dhe u ri-shtrua pas komplikacioneve. Ndërsa mediat e deklaroronin të vdekur në Ukrainë, ai pranoi se kishte qenë në Ukrainë, por ishte kthyer në SHBA pas vizitës së tij zyrtare.

Si të verifikoni fotot dhe videot e krijuara nga AI?

- Reverse image search Google [Kërkim i kundërt i imazheve në Google]
- Përmes Deepware
- Përmes faqes "Ai or not"



### c) Rusia do të fillojë Luftën e Tretë Botërore/Luftën Bërthamore

Një nga narrativat më të përhapura në media shqiptare pas pushtimit të Rusisë në Ukrainë është ajo për fillimin e Luftës së Tretë Botërore, veçanërisht i luftës bërthamore që do të shkatërrojë botën. Duke u bazuar në tabloidet britanike dhe gjermane, si dhe në deklaratat e Kremlinit, mediat shqiptare kanë nxitur frikën për një luftë botërore që nga fillimi i pushtimit. Tituj si "Dosja sekrete gjermane/Plani i Putin për fillimin e Luftës së Tretë Botërore në verën e ardhshme," janë të zakonshme dhe publikohen rregullisht çdo javë në portale dhe kanale lajmesh shqiptare. Këto narrativa, të cilat shkaktojnë emocione dhe rrisin interesin e angazhimin në portale, kontribuojnë në propagandën ruse (për shembull, pretendimet se sanksionet kundër Rusisë nuk po funksionojnë, ose se Rusia po fiton luftën). Ato krijojnë panik në popullatën e gjerë dhe




shqetësime që mund t'i shtyjnë njerëzit të ndërhyjnë politikisht për të ndaluar presionin mbi Rusinë.

Një tjetër shembull i kësaj narrative gjendet në artikuj të ndryshëm që flasin për përdorimin e armëve kimike, si në rastin e mëposhtëm:

## Shembulli 2

### Lufta në Ukrainë dhe armët kimike



Që prej datës 5 shkurt, disa llogari pro-ruse kanë shpërndarë imazhe që pretendojnë se dokumentojnë përdorimin e armëve kimike nga trupat ukrainase. Verifikimet kanë zbuluar se nuk ka prova bindëse për t'i mbështetur këto akuza, të cilat do të konsideroheshin shkelje serioze të konventave ndërkombëtare. Po ashtu, që nga muaj shkurt, disa llogari pro-ruse kanë shpërndarë video në rrjetet sociale, duke pretenduar se ushtarët ukrainas përdorin armë kimike në luftën kundër rusëve. Siç është rasti me armët bërthamore, armët kimike janë kategorikisht të ndaluara për përdorimin në luftë sipas konventave ndërkombëtare dhe klasifikohen si armë të shkatërrimit në masë. Megjithatë, akuzat nuk kanë asnjë bazë nga vëzhgimet në terren, ndërsa përdorues të ndryshëm në rrjet kanë shpërndarë imazhe filmike, duke përfshirë një profil shqiptar në rrjetin social Facebook. Ukrainian Yuriy "The Magyar" ka publikuar një video që tregon municione kimike dhe ka "aluduar" se ukrainasit po përgatiten të përdorin municione të ndaluara në Bakhmut [Artemovsk] - shkruan më 7

shkurt personi në fjalë, duke publikuar videon që ka tërhequr vëmendjen e dhjetëra përdoruesve të tjerë të Facebook. Videoja tregon një sasi të konsiderueshme bombolash të kuqe dhe të zeza, të rrethuara nga dronë, që duket se përdoren për të shpërndarë bomba në zonat ku janë vendosur ushtarët rusë. Në video, bombolat cilindrike, që supozohen se mbajnë lëndë kimike, tregohen të ruajtura në një ambient të ftohtë. Në sfond dëgjohe muzikë dhe një burrë komenton skenën me zë të lartë. Pas verifikimeve të bëra nga kolegët tanë në France 24, detajet e situatës u qartësuan më shumë. Gazetarët francezë arritën të kontaktonin ushtarin ukrainas Robert Madia, i cili shfaqet në videon e publikuar, dhe kjo dallohet nga emri që ai ka në uniformën e tij. Është vetë ky ushtar që shpjegon nëpërmjet një videoje tjetër se bëhet fjalë për ngarkesa eksplozive që po përgatiten për t'u transportuar me dron dhe për të sulmuar automjete ushtarake ose objektiva të tjerë armiqësorë. Kolegët e France 24 i konsultuan këto informacione me ekspertë të fushës, të cilët bien dakord se nuk bëhet fjalë për armë të rrezikshme kimike. Në këtë rast, ekspertët konfirmojnë se bombat nuk do të kapeshin dhe montoheshin pa masa mbrojtëse (maska apo doreza). Përveç kësaj, përdorimi i armëve kimike në luftë nuk do të kalonte pa u dalluar menjëherë dhe do të denoncohej nga rusët. Deri më tani, nuk ka raste të tilla të raportuara, madje edhe pa prova, nga autoritetet zyrtare ruse.

<https://faktoje.al/e-rreme-video-qe-provon-perdorimin-e-armeve-kimike-nga-ukrainasit/>



#### **d) Luftërat e vendeve të treta në Ballkanin Perëndimor**

Lidhjet e ngushta midis Rusisë dhe Serbisë, grupimeve të caktuara në Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë, e kanë bërë rajonin veçanërisht vulnerabël jo vetëm ndaj disinformimit, por edhe ndaj interesave strategjike të Rusisë. Ndjenja nacionaliste për Serbinë e Madhe është rritur gjatë viteve dhe është intensifikuar pas pushtimit të Rusisë në Ukrainë, i cili e ka fuqizuar ndjenjën nacionaliste në vende me popullsi të konsiderueshme serbe. Situata midis Kosovës dhe Serbisë, dhe veçanërisht ngjarjet dhe konfliktet e lidhura me pjesën veriore të Kosovës, janë bërë shkak i disinformimit dhe narrativave që përkeqësojnë tensionin, konfliktin, dhe krijojnë ndjenja pasigurie. Narrativat për përshkallëzime të mundshme që do shkaktonin luftë në rajon kanë dalë në pah sa herë që dy qeveritë janë përplasur për çështje traktatesh si kartat e identitetit kombëtar,

zgjedhjet, targat e makinave, dhe Asociacioni i Komunave Serbe. Këto narrativa, si narrativat për një luftë të mundshme bërthamore, lehtësojnë mosmarrëveshjet dhe konfliktet që ndihmojnë projektin global të Rusisë.

Disinformimi mbetet ende një sfidë dhe shpesh është i vështirë për t'u dalluar. Por në përgjithësi, ka shenja që mund të përdoren lehtësisht për zbulimin e tij.

## Rasti

### Studimor 4

## Lufta midis Kosovës dhe Serbisë

Mediat shqiptare dhe serbe aktivizojnë alarmin e luftës kur qeveritë e Serbisë dhe Kosovës [sidomos kjo e fundit] njoftojnë zbatimin e ligjeve të reja që rregullojnë lëvizjen ose shkëmbimin e njerëzve dhe mallrave mes dy vendeve.

Në qershor të vitit 2022, qeveria e Albin Kurtit miratoi një ligj për zbatimin e masave reciproke me Serbinë në lidhje me kartat e identitetit. Sipas këtij ligji, duke u nisur nga data 1 korrik 2022, qytetarët serbë me dokumente serbe do të ishin të detyruar të paraqesin kartat e identitetit të Kosovës kur janë në territorin e Kosovës. Kjo masë synonte qytetarët serbë të Kosovës, të cilët shpesh vazhdojnë të mbajnë targa dhe dokumente serbe pavarësisht faktit që jetojnë në Kosovë. Vendimi i qeverisë së Kosovës u përputh me politikat identike të zbatuara nga qeveria serbe për udhëtarët nga Kosova.

Qeveria e Kosovës njoftoi planet e saj në fillim të qershorit, me qëllim zbatimin e kësaj masë në 1 korrik 2022. Reagimet e ashpra të Presidentit serb Aleksandër Vuçiç dhe thirrjet e tij për popullsinë serbe të Kosovës shkaktuan tensione në veri të Kosovës dhe pas ndërhyrjes së Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, vendimi u shty deri më 1 shtator. Në dy muajt që pasuan, të dyja palët u takuan në Bruksel ku më 27 gusht arritën një marrëveshje: nga 1 shtatori, udhëtarëve nga Kosova nuk do t'u kërkohet të paraqesin kartat e identitetit serbe në kufi. Prandaj, Kosova nuk do ta zbatojë ligjin për kartat e identitetit në qershor të këtij viti.

Megjithatë, gjatë periudhës nga dita kur u arrit marrëveshja deri në ditën e zbatimit [pra, 1 shtator], mediat shqiptare ngritën alarmin për një luftë potenciale mes dy vendeve.

Madje edhe në mëngjesin e datës 1 gusht, u raportua për stërvitje ushtarake në kufirin mes Serbisë dhe Kosovës, të cilat u konsideruan si të rrezikshme. Kjo

ndodhi edhe pse Ministria e Mbrojtjes serbe bëri një deklaratë paraprake duke shpjeguar se këto stërvitje ishin rutinore dhe zhvilloheshin çdo vit.

Megjithatë, mëngjesi i 1 shtatorit i gjeti kufijtë mes Kosovës dhe Serbisë të qetë. Raportet nga terreni në media si Radio Evropa e Lirë ose Klan Kosova treguan se ligjet e ndryshuara po zbatoheshin menjëherë dhe kryesisht pa probleme.

Një luftë e parashikuar

Lajmet se Serbia dhe Kosova janë në prag lufte nuk janë diçka e re. Ka një histori relativisht të gjatë të situatës së përshkruar më lart: qeveria e Kosovës zbaton një ligj të ri, Serbia reagon, mediat flasin për konflikt të armatosur ose madje edhe luftë, ndërsa palët dërgohen shpejt në Bruksel për dialog. Arrihen marrëveshje të ndryshme, disa më definitive se të tjera, dhe frika nga lufta zbehet. Edhe nëse një marrëveshje përfundimtare mbetet e paqartë, zbatohen masa të përkohshme që situata të mos përshkallëzojë më tej ose mos të shndërrohet në luftë të hapur.

Vini re datën e këtij artikulli: Janar 2017

<https://faktoje.al/perse-jane-te-paqena-paralajmerimet-per-lufte-midis-kosoves-dhe-serbise/>

**Rasti**

**Studimor 3**

## **Zelenski paralajmëron luftë në Ballkanin Perëndimor**

### ***Paralajmërimi i Zelenskit***

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka paralajmëruar se Rusia mund të ketë në plan të nisë një luftë në Ballkan për të devijuar vëmendjen nga lufta që vijon në Ukrainë. “Kushtojini vëmendje Ballkanit. Më besoni, po marrim informacione që Rusia ka një plan afatgjatë,” ka raportuar Agjencia Ukrainase e Lajmeve të ketë thënë Zelenski.

Më tej, në një intervistë për tabloidin britanik “The Sun,” Zelenski shkoi edhe më larg me skenarin “apokaliptik” duke paralajmëruar për përshkallëzim në një luftë të tretë botërore.

“Ukraina është sot në qendër të një rreziku global për luftë botërore. Besoj vërtetë se Rusia do ta shtyjë deri sa SHBA-ja dhe Kina t’i thonë të tërhiqet nga Ukraina. Pasi Evropa nuk mund ta bëjë këtë vetëm. Rusia

nuk ndjen se gjithë bota është kundër saj. Prandaj, ne mendojmë që ata tani po përgatisin hapa të tjerë në Ballkan dhe po përpiqen të stërviten ose kanë filluar tashmë të stërvitin disa persona dhe nuk do të ndalet, sepse ideja e tyre është të nisin një konflikt dhe të ndezin zjarre të tjera përreth. Destabilizimi përmes nxitjes së konflikteve të reja” – tha Zelenski për The Sun.

### ***Mbulimi mediatik***

Lajmi për deklaratën e Zelenskit u raportua gjerësisht në median shqiptare si kërcënim për Ballkanin. Më pas, paralajmërimi i Zelenskit për një luftë të mundshme u raportua si fakt i konfirmuar, duke përfshirë edhe pretendimet se Bashkimi Evropian është i shqetësuar për mundësinë e një luftë në Ballkanin Perëndimor.

Në fakt, deklaratat e publikuara nga NATO dhe BE-ja njohin përpjekjet aktuale të Rusisë për ta zgjeruar ndikimin e saj në Ballkan, por në asnjë moment nuk përputhen me pretendimet për një luftë të mundshme në Ballkan.

### ***Reagimi ndërkombëtar***

Dy ditë pas deklaratës së Zelenskit, në fillim të turneut të tij në Ballkanin Perëndimor në Bosnjë dhe Hercegovinë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, shprehu shqetësim për ndërhyrjet dashakeqëse të huaja, përfshirë ato të Rusisë, që kërcënojnë të përkeqësojnë stabilitetin dhe të pengojnë reformat në rajon. Pyetur nga gazetarët në Maqedoninë e Veriut për paralajmërimin e Zelenskit, Stoltenberg theksoi se NATO është gati për çdo përshtetëzim, por deklaroi se në këtë moment nuk ka rrezik të qartë për anëtarët e saj. Edhe Bashkimi Evropian ndoqi të njëjtën linjë. Në një konferencë për shtyp, zëdhënësi i Komisionit Evropian u përgjigj një pyetjeje të ngjashme për paralajmërimin e Volodimir Zelenskit.

“Që prej shumë kohësh kemi thënë se Rusia po përpriqet të ushtrojë ndikimin e saj të negativ në territorin e Ballkanit Perëndimor. Pra, po, ky është një shqetësim, por nuk është shqetësim i ri; ne e kemi pasur këtë shqetësim që prej shumë kohësh, ndaj jemi në përputhje me presidentin ukrainas në këtë drejtim dhe e dimë se Rusia po bën çmos të mbjellë pakënaqësi, paqëndrueshmëri politike, ndikim të huaj, manipulim të informacionit e kështu me radhë.” – deklaroi Peter Stano, Zëdhënësi i Komisionit Evropian, më 20 nëntor 2023.

### Raporti i Inteligjencës Amerikane parashikon luftë në Ballkan

“Alarm! Inteligjenca Amerikane: Luftë në Ballkan? Eksperti: Qëllimi është Serbia e Madhe”

Kështu njoftoi televizioni shtetëror i Shqipërisë, RTSH, më 15 mars 2024, duke cituar një raport të Inteligjencës Amerikane që, sipas tyre, parashikonte një luftë të mundshme në Ballkan. “Inteligjenca amerikane parashikon se në vitin 2024 Ballkani Perëndimor mund të përjetojë një situatë pasigurie, duke sjellë dhunë dhe shfaqje të kryengritjeve ndëretnike” – bën të ditur RTSH-ja, e cila organizoi një diskutim në studio për këtë çështje përreth 30 minuta.

Në këtë rast, RTSH-ja po i referohet një raporti të ODNI, Zyrës së Drejtorit të Inteligjencës Kombëtare të qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Sipas këtij raporti, gjatë vitit 2024, rajoni i Ballkanit Perëndimor mund të përballët me një rritje të rrezikut të dhunës ndëretnike lokale.

“Ballkani Perëndimor pritet të përjetojë një rritje të rrezikut të dhunës së lokalizuar ndëretnike gjatë 2024. Liderët nacionalistë do të përpiqen të përkeqësojnë tensionet për të përfituar politikisht, ndërsa aktorët e jashtëm pritet të përforcojnë dhe përfitojnë nga dallimet etnike për të shtuar ose për të mbrojtur ndikimin e tyre rajonal, ose për të penguar integrimin e mëtejshëm të Ballkanit në BE ose në institucionet Euro-Atlantike,” thotë raporti i ODNI për vitin 2024.

Raporti përfshin shembuj të këtyre përplasjeve të lokalizuara ndëretnike, si sulmet në Banjskë gjatë vitit 2023 dhe provokimet e Milorad Dodikut në Bosnjë lidhur me shkëputjen e Republikës Srpska. Megjithatë, në asnjë moment raporti nuk përmend një luftë të mundshme në Ballkan, ose edhe ndërmjet dy shteteve që aktualisht janë në një situatë konfliktuale me njëra-tjetrën, duke kundërshtuar atë që po sugjeron RTSH-ja. Lajmi për “mungesën e stabilitetit në Ballkan” u raportua në disa media të mëdha në vend. Një media tjetër njoftoi se Raporti i Uashingtonit paralajmëron se Ballkani Perëndimor “ka rrezik të destabilizohet nga konflikte të ushqyera nga vende që kanë interes në kontrollimin e rajonit, si Rusia.”

Artikulli vazhdon duke cituar gabimisht raportin:

Ballkani Perëndimor me shumë mundësi do të përballët me rrezikun e shtimit të dhunës ndëretnike në vitin 2024.” – shkruan artikulli, ku vihet re përjashtimi i fjalës “i lokalizur” nga raporti origjinal.

\* Keqinterpretimi i raportit të ODNI.

Përdorimi i titujve të ekzagjeruar ose keqinterpretimi i raporteve apo deklaratave për të “paralajmëruar” luftëra të ardhshme është shkelje e përsëritur në median shqiptare e më gjerë. Fakte shpesh ka hedhur poshtë tituj të tillë të përdorur për “klikime” që përhapin frikë te lexuesit në vend që t’i informojnë ata.

<https://faktoje.al/raporti-i-inteligjences-amerikane-nuk-parashikoi-lufte-ne-ballkan/>



## Shembulli 4

Trajnimi i fëmijëve me armë në Serbi

# “Serbia po trajnon fëmijët për luftë”



10 MAJ 2023, 12:05 / RAJONI  
TEMA



Burimi: [Gazeta Tema](#)





Një fotografi e ngjashme e tillë u publikua më 13 maj 2023 nga gazeta shqiptare Tema me titullin: “Serbia po trajnon ushtarë fëmijë”. Postimi origjinal i referohet një videoje të një eksperti sigurie në Twitter [tani platforma X] pasi një fëmijë 13-vjeçar vrau 8 fëmijë në një shkollë në Beograd. Eksperti theksoi se kjo situatë është ndikuar nga stërvitjet e fëmijëve për përdorimin e armëve. Faktaje verifikoi postimin për të kuptuar nëse është e vërtetë që fëmijët në Serbi trajnohen nga forcat ruse. Verifikimi përmes kërkimit të kundërt të imazhit në Google tregoi se fotoja daton 5 vjet më parë.

<https://faktoje.al/31949-2/>



## Flamujt e kuq - Treguesit e disinformimit

- titulli nuk përputhet/mbështetet me tekstin dhe teksti fokusohet në diçka krejt ndryshe;
- nuk ka referenca specifike dhe po përdoren burime të dyshimta ose anonime;
- imazhet dhe videot që shoqërojnë artikullin e lajmit janë të dyshimta;
- lajmi përmban sasi të tepërta emocionesh, pyetjesh apo thirrjesh;
- artikulli i lajmit bazohet/mbështetet mbi ekspertë të njëanshëm

## Shembuj të disinformimit

### Imazhet e Luftës së Dytë Botërore po përdoren për luftën në Ukrainë.

<https://faktoje.al/foto-nga-lufta-ii-boterore-po-shiten-si-pamje-nga-lufta-ne-ukraine/>

Imazhet e fëmijëve gjatë luftës në Ukrainë janë përdorur që në fillim të saj dhe në mënyrë të vazhdueshme për të ilustruar luftën. Media shqiptare e botoi këtë foto lajm në shkurt të vitit 2022, e cila u ripublikuar shumë herë më pas. Përmes motorit të kërkimit TinEye, u zbulua se data dhe origjina e kësaj fotoje është në vitin 1945







STOCK - SPONSORED  
www.alamy.com  
stock-photo-vintage-photo-of-a-child-a... - First found on Sep 5, 2021



iwpfundacja.pl  
iwpfundacja.pl - First found on Nov 9, 2019  
Filename: fd9e093286fba4cc2ba3d904d500896218.jpg (495 x 450, 29.9 kB)



onedio.com  
haber/djital-ortamda-gerecki-bir-eecki... - First found on Mar 19, 2019  
Filename: s-59025df13b2e96c7fc0b7de41481848878ba778.jpg  
(500 x 518, 76.3 kB)



www.incrediblethings.com  
art-design/historic-photos-colored-to... - First found on Dec 13, 2019  
Filename: colorized-historical-photos-4.jpg (595 x 617, 296 kB)

nga Tony Frisell, me përshkrimin: “Një djalë i braktisur që mban një lodër në duar gjatë bombardimeve ajrore në Londër në 1945”.

## Si të zbuloni disinformimin dhe informacionin e rreme gjatë konflikteve dhe kohërave të luftës?

Analizoni se kush është autori i informacionit, cili mund të jetë qëllimi i krijimit të këtij postimi apo artikulli, si dhe çfarë formimi dhe përvoja ka ai.

- Kontrolloni nëse edhe dikush tjetër po e përhap të njëjtin informacion, veçanërisht nëse kjo bëhet nga burime të njohura dhe me autoritet.
- Nëse informacioni po përhapet vetëm nga ky burim, atëherë nevojitet të shqyrtohet se nga ku u mor një informacion i tillë ekskluziv që të tjerët nuk e kanë zbuluar.
- Pavarësisht se sa me autoritet mund të jetë burimi, duhet të kontrollohet burimi parësor.
- Kushtojni vëmendje datës së informacionit: ndonjëherë një ngjarje/ deklaratë e vjetër prezantohet sikur të kishte ndodhur/të ishte bërë së fundmi.


## Ushtarët ukrainas që largohen nga familjet e tyre

Një tjetër lajm jepet duke publikuar imazhe të ushtarëve ukrainas që takojnë për herë të fundit bashkëshortet dhe të fejuarat e tyre. Një kërkim i thjeshtë me Google Reverse Image dhe Youtube tregoi se imazhet nuk përshkruanin realitetin, por ishin marrë nga një film ukrainas me titull “Lufta e Kimerave”.



#ShqiperiaLive #TopChannel

Ushtarët ukrainas puthin të dashurat para se të ikin në luftë, moment prekës-  
Shqipëria Live



The War of Chimeras \ Війна химер (2017) - Trailer

60,336 views • Jul 7, 2017

LIKE DISLIKE SHARE SAVE ...

## Përdorimi i përmbajtjeve mediatike të rreme (video/foto) gjatë luftës

Imazhet/videot e rreme (Deep fakes) përdoren si metodë për krijimin e përmbajtjeve mediatike të rreme, si video, audio ose imazhe përmes rrjeteve nervore artificiale dhe mësimit të thellë, veçanërisht përmes modeleve gjenerative.

- Zakonisht lidhen me autoritetet zyrtare ose personelin ushtarak që marrin vendime ose japin urdhra.
- Krijohen gjatë krizave të rënda kur mundësitë e verifikimit dhe qartësisht të informacionit nga publiku janë të kufizuara.
- Përhapen përmes mediave sociale ose faqeve të krijuara posaçërisht për këtë qëllim.
- Rusia shpesh përdor kanale anonime në Telegram për përhapjen e disinformimit.

### Shembulli 5

#### Video e rreme e Volodimir Zelenskit

Videoja tregon Presidentin Ukrainas që u kërkon forcave të tij të dorëzojnë armët. Imazhet janë manipuluar duke përdorur lëvizje me qëllim krijimin e një videoje të rremë. Çdo gjë e pazakontë në këtë video, si lëvizjet e përsëritura ose zëri, mund të shtyjë një gazetar të ketë dyshime, të hulumtojë më thellë dhe të verifikojë më tej.

<https://www.youtube.com/watch?v=X17yrEV5sl4&t=7s>



### Shembulli 6

#### Fotografi të ushtarëve ukrainas që luten për shpëtim

Një rast tjetër i përmbajtjeve mediatike të rreme është ai i imazheve që tregojnë Presidentin rus Vladimir Putin teksa arrestohet. Këto imazhe u postuan në Twitter [tani platforma X] në mars të vitit 2024. Verifikimi i mëtejshëm nga verifikuesit e fakteve tregoi se imazhet janë krijuar nga një program inteligjencë artificiale.



### Imazhet e arrestimit të Putin - krijuar nga inteligjenca artificiale



Ndonëse shumica e mediave kanë raportuar se imazhet që tregojnë Presidentin Putin tekta “arrestohet” janë produkt i programeve të inteligjencës artificiale (IA), këto imazhe po qarkullojnë edhe në rrjetet sociale duke u nxjerrë jashtë kontekstit. Fotoja më lart është krijuar nga një program i inteligjencës artificiale (IA). Imazhi i mësipërm u postua më 20 mars në Twitter, bashkë me imazhe të tjera që tregojnë skena nga “arrestimi” i Putin, të shoqëruar me përshkrimin “rrjeti neural shkruan gjëra të bukura”. Rrjeti neural i referohet mënyrës se si punojnë programet e inteligjencës artificiale. “Faktoje” ka verifikuar më parë imazhe të krijuara nga IA që janë marrë si të vërteta në rrjetet sociale.

<https://faktoje.al/arrestimi-i-putin-krijim-i-inteligjences-artificiale/>



### Këshilla për verifikuesit e rinj të fakteve

- Identifikoni burimin kryesor: gjeni citatin, raportin, origjinën e fotos.
- Merrni kohën e duhur për ta lexuar dhe për ta kuptuar burimin kryesor.
- Jini transparent: shpjegoni pse dhe si e bëni verifikimin.
- Telefononi gjithmonë personin, fjalët e të cilit po verifikoni.
- Ruani neutralitetin dhe shmangni shprehjen e mendimit personal në rrjete sociale.
- Jepni përgjigje me nuanca ose të prerë, por gjithmonë të qartë.
- Bëni korrigjimin e gabimeve tuaja duke publikuar gabimin në mënyrë të dukshme

## Kërkimi dixhital - Këshilla Praktike

### Google

Njih tekstin në imazhe/mundësi për ndryshimin e fjalëve kyçe për kërkime më të sakta

### Bing

Kërkim i seksioneve të imazhit [kërkim vizual], njih fytyra dhe në disa raste nxjerr tekstin e imazheve

### Yandex

Bën kërkim të seksioneve të imazhit, lexon, nxjerr dhe përkthen tekstin e fotove, njih fytyrat

### TinEye

Rendit sipas datës/madhësisë së imazhit

### Google Lens

Analizon fotot dhe njih llojet e makinave, bimët, kafshët dhe objektet pjesërisht të fshehura Hapet në Google Chrome përmes menysë kontekstuale ose mund të përdorni shtojcën "Search by Image"

## Për efikasitet të lartë, është thelbësore që verifikuesit e fakteve:

- Të përdorin të gjitha metodat dhe mjetet e verifikimit, si digjitale ashtu edhe tradicionale;
- Të komunikojnë personalisht me dëshmitarët;
- T'u kushtojnë vëmendje detajeve;
- Të identifikojnë modele të gatshme dhe përsëritje në histori, duke zbuluar narrativat themelore;
- Të zhvillojnë rrjetin e partnerëve të komunikimit

## UDHËZIME PËR LUFTËN KUNDËR DISINFORMIMIT



Luftimi i disinformimit gjatë periudhave të konfliktit është thelbësor për ruajtjen e stabilitetit dhe për të siguruar që informacioni të arrijë i saktë te publiku. Më poshtë jepen disa udhëzime për t'i ardhur në ndihmë kësaj lufte:

**Komunikimi transparent:** Qeveritë dhe burimet e besueshme duhet të japin informacion të saktë, të rregullt dhe transparent për publikun. Komunikimi i hapur ndihmon në ndërtimin e besimit dhe zvogëlon përhapjen e thashethemeve dhe gënjeshtreve. Transparenca nënkupton të qenit të hapur dhe të sinqertë në platformat e mediave sociale.

**Verifikimi i fakteve:** Krijoni organizata ose iniciativa të pavarura për verifikimin e informacionit që shpërndahet në mediat tradicionale dhe sociale. Verifikimi i shpejtë i fakteve mund të hedhë poshtë narrativat e rreme para se ato të përhapen.

**Kundërnarrativat:** Zhvilloni dhe përhapni kundërnarrativa për të hedhur poshtë informacionin e rremë dhe propagandën. Theksimi i së vërtetës ul besueshmërinë e fushatave të disinformimit.

**Bashkëpunimi:** Nxitni bashkëpunimin mes qeverive, organizatave mediatike, shoqërisë civile dhe kompanive teknologjike për ta adresuar disinformimin në mënyrë efektive. Përpjekjet e përbashkëta mund të përforcojnë ndikimin e nismave dhe të promovojnë mesazhe të vërteta.

**Fuqizimi i gazetarisë së pavarur:** Mbështesni gazetarinë e pavarur dhe raportimin investigativ për të zbuluar dhe ekspozuar fushatat e disinformimit. Gazetarët kanë rol të rëndësishëm në sigurimin e llogaridhënies nga ana e pushtetit dhe në informimin e publikut.

**Bashkëpunimi ndërkombëtar:** Forconi bashkëpunimin ndërkombëtar për të adresuar kërcënimet e disinformimit transnacional.

Bashkëpunimi mes vendeve mund të lehtësojë ndarjen e informacionit, mbledhjen e inteligjencës dhe përgjigjet e koordinuara ndaj disinformimit.

**Fushatat e ndërgjegjësimit publik:** Organizoni fushata për ndërgjegjësimin publik për të edukuar qytetarët mbi rreziqet e disinformimit dhe rëndësinë e mendimit kritik. Inkurajoni individët të dyshojnë tek burimet, të verifikojnë informacionin dhe të mendojnë në mënyrë kritike para se ta shpërndajnë përmbajtjen.

**Investimi në teknologji:** Investoni në teknologji për të zbuluar dhe luftuar disinformimit, duke përfshirë inteligjencën artificiale, mësimin automatik dhe përpunimin e gjuhës natyrore. Mjetet automatike mund të ndihmojnë në identifikimin e informacionit të rremë dhe në analizimin e ndikimit të tij në shoqëri.

Duke i zbatuar këto udhëzime, qeveritë, organizatat mediatike dhe shoqëria civile mund të bashkëpunojnë për të zvogëluar efektet dëmtuese të disinformimit gjatë kohërave së luftës dhe konflikteve.



### ***Për gazetarët/redaktorët***

- *Monitorimi sistematik dhe analiza narrative për të identifikuar ndryshimet tematike dhe substanciale, si dhe për të parashikuar kërcënime të reja.*

Teksa narrativat e disinformimit nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm si proceset politike, ngjarjet e papritura, evoluojnë, është e rëndësishme të rivlerësohen rregullisht analizat narrative për të parashikuar kërcënime dhe për të identifikuar grupet dhe komunitetet kyçe të targetuara. Rekomandojmë përdorimin e mjeteve vëzhguese dhe kompjuterike për monitorimin e disinformimit, ndërsa përforcohen aftësitë e analistëve dhe verifikuesve të fakteve në lidhje me kërcënimet dhe mënyrën se si ato përhapen.

- *Përmirësimi dhe ofrimi i mbështetjes së operacioneve dhe përpjekjeve të verifikimit të fakteve.*

Kanalet mediatike dhe verifikuesit e fakteve duhet të bëjnë më shumë për të hedhur poshtë narrativat e disinformimit që qarkullojnë në mediat shqiptare. Mediat duhet të rrisin ndërgjegjësimin ndaj kërcënimet të narrativave të disinformimit rus në Shqipëri. Mbështetja e trajnimeve të gazetarëve, redaktorëve dhe verifikuesve të fakteve për të identifikuar narrativat e informacionit rus, me synim identifikimin dhe hedhjen poshtë të këtyre narrativave.

- *Analizimi i teknologjive dhe mjeteve të përdorura nga disinformimi për gjenerimin e lajmeve të rreme.*

Në procesin e fushatave të disinformimit, janë përdorur teknologji të ndryshme për gjenerimin e informacioneve të rreme, manipuluese - imazhe të rreme, audio të rreme dhe mesazhe foto/video të rreme. Monitorimi dhe analiza e rregullt na lejojnë të ndjekim jo vetëm



narrativën, por edhe aspektet teknologjike që fshihen pas gjenerimit dhe shpërndarjes së disinformimit, si dhe për të përgatitur strategjitë dhe metodat e verifikimit dhe përgënjeshtimit.

- *Informimi dhe edukimi i rregullt i palëve të ndryshme për trendet e disinformimit.*

Zhvillimi i një sistemi informimi të rregullt të të gjitha palëve të interesit. Përfshirja e rezultateve të analizës sistematike të trendeve narrative të disinformimit në raportet dhe diskutimet publike; qartësimi i trendeve dhe kërcënimeve në të gjitha nivelet, dhe angazhimi i audiencës së gjerë në këtë proces.

- *Nxitja e bashkëpunimit ndërdisiplinor mes studiuesve.*

Redaktorët, gazetarët, studiuesit dhe verifikuesit e fakteve duhet të përforcojnë njohuritë dhe kapacitetet e tyre për të identifikuar narrativat pro-Kremlin të përhapura nga ekosistemi i mediave të sponsorizuara nga shteti ose nga deklaratat e institucioneve dhe zyrtarëve rusë nëpërmjet platformave të mediave sociale.

- *Krijimi i një baze të dhënash të disponueshme për publikun me shembuj disinformimi.*

Zhvillimi i një baze të dhënash bazuar në të dhënat e mbledhura nga verifikuesit e fakteve, e cila të jetë publikisht e aksesueshme me shembuj të disinformimit të shoqëruar me karakteristikat narrative të përmbajtjeve të llojeve të ndryshme me qëllim që të përdoret nga komuniteti i verifikimit të fakteve dhe palët e tjera të interesit.

### ***Rekomandime për organet rregullatore/qeveritare***

- *Zhvillimi i kriterëve për identifikimin e agjentëve dhe burimeve të disinformimit.*

Pavarësisht tendencave të disinformimit për të ndryshuar dhe për t'iu përshtatur masave ndaluese dhe sanksioneve, qeveria, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e verifikimit të fakteve dhe akademinë, duhet të punojë për të përcaktuar kriterë më të gjëra për agjentët, aktorët e disinformimit dhe ndërprerësit e proceseve të informimit.

- *Përfshirja e verifikuesve të fakteve në procesin e hartimit të politikave lidhur me luftimin e disinformimit.*

Aktiviteti sistematik i organizatave të verifikimit të fakteve lejon identifikimin e veçorive teknologjike, narrative dhe të sjelljes të proceseve të lidhura me transmetimin dhe konsumimin e informacionit nga grupet e ndryshme. Rregullatorët e medias dhe qeveria mund të përdorin përvojën dhe vëzhgimet e tyre për të zhvilluar politika dhe për të hartuar legjislacion në fushën e informacionit dhe luftën kundër disinformimit.

- *Rritja e ndërgjegjësimit publik përmes mbështetjes së fushatave publike dhe të atyre për edukimin mediatik.*

Përfshirja e çështjeve të lidhura me disinformimin, propagandën dhe verifikimin e informacionit në kurrikulat për grupmoshat e ndryshme në të gjitha fazat e arsimit kombëtar në mënyrë të rregullt. Mbështetja e nismave për edukim mediatik që zhvillojnë dhe promovojnë fushatat informative për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj rolit të verifikimit të fakteve dhe të edukimit mediatik, si dhe përfshirja e mediave të llojeve të ndryshme (edukative, televizive, radio, online) në këto fushata.

- *Mbështetja e përfshirjes së përpjekjeve dhe metodave të verifikimit të fakteve në studimet e gazetarisë, si dhe në edukimin e publikut.*

Edukimi i publikut mbi përfundimin e aftësive për të filtruar dhe përpunuar informacionin është shumë i rëndësishëm në luftën kundër disinformimit dhe keqinformimit. Organet rregullatore dhe qeveria duhet të mbështesin edukimin publik përmes aktiviteteve të ndryshme që përfshijnë metodat dhe mjetet e verifikimit të fakteve dhe, më e rëndësishmja, të mbështesin dhe promovojnë përfshirjen e përpjekjeve të verifikimit të fakteve në studimet e gazetarisë.

## REFERENCA

- Allcott, H., & Gentzkow, M. (2017). Media sociale dhe lajmet e rreme në zgjedhjet e vitit 2016. *Revista për perspektivat ekonomike*, 31(2), 211-236., 31(2), 211-236.
- Gerguri, D. (2022) Taktikat e disinformimit kundër NATO-s nga Lufta në Kosovë. Mind Community
- Greene, S., Asmolov, G., Fagan, A., Fridman, O., & Gjuzelov, B. (2021). Hartëzimi i lajmeve të rreme dhe disinformimit në Ballkanin Perëndimor dhe Identifikimi i mënyrave efektive për t'i luftuar ata. *Parlamenti Evropian, Komiteti i Parlamentit Evropian për Çështjet e Jashtme. BE: Bashkimi Evropian*.
- Churanova, O., & Romaniuk, V. (2023). Narrativat kundër BE-së nëpërmjet luftës ruso-ukrainase në kontekstin e përgënjeshtimeve të StopFake.org.
- Lazer, D. M., Baum, M. A., Benkler, Y., Berinsky, A. J., Greenhill, K. M., Menczer, F., ... & Zittrain, J. L. (2018). Shkenca e lajmeve të rreme. *Shkenca*, 359(6380), 1094-1096.
- Qendra e Ekselencës për Komunikime Strategjike e NATO-s. Prania e Rusisë në Ambientin e Informacionit në Ballkanin Perëndimor (2020). Gjetend në: <https://stratcomcoe.org/publications/russias-footprint-in-the-western-balkan-information-environment-summary/51>
- Pomerantsev, P. (2024) *Si të fitosh një luftë informimi: Propagandisti që mposhti Hitlerin*. Nju Jork: Çështje Publike.
- Rregullimi i të dhënave: Përgënjeshtrimi i disinformimit rus për NATO (2024). Gjetend në: <https://www.nato.int/cps/en/natohq/115204.htm>.
- Voko, K. & Likmeta, B. (2023) Narrativat e disinformimit të sponsorizuara nga shteti rus në Shqipëri; Rrjeti i Gazetarisë Hetimore Ballkanike (BIRN). Gjetend në: <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2023/07/Russian-state-sponsored-disinformation-narratives-in-Albania.pdf>
- Wardle & Derakhshan, H., 2017. Çrregullimi i informacionit: Drejt një strukture ndërdisiplinore për kërkimin dhe hartimin e politikave. Strasbourg, Francë: Këshilli i Evropës

## HYRJE

Në kontekstin e luftërave dhe konflikteve, propaganda gjithmonë ka luajtur një rol kyç në zhvillimin e luftës, pasi subjektet shtetërore dhe jo-shtetërore të përfshira në të kërkojnë të krijojnë mbështetje për të justifikuar veprimet e tyre, për t'i penguar të tjerët të përfshihen në konflikt dhe për ta mbajtur popullsinë nën kontroll.

Raportimi i luftërave dhe konflikteve kërkon vërtetësi, balancë dhe paanshmëri, por janë pikërisht këto cilësi të rëndësishme që vështirë se gjenden në kohërat e sotme. Në fakt, fabrikimi i informacionit nuk është diçka e re. “Përdorimi i propagandës është i kahershëm, por kurrë më parë nuk ka pasur teknologji për ta përhapur atë në mënyrë kaq efektive”, argumentoi kolumnistja e Guardian, Natalie Nougayrède.

“Çrregullimi i informacionit” i shekullit të 21 është ndikuar gjerësisht nga përdorimi i teknologjisë dhe nga një numër i pakufizuar platformash përmes të cilave informacioni përhapet në kohë reale. Lufta bashkëkohore ka një dimension të komplikuar shtesë: jo vetëm që transmetohet në televizion, por ndahet dhe përjetohet online në kohë reale gjithnjë e më shumë.

Në momente konflikti dhe pasigurie, miliona njerëz kërkojnë informacion në internet (dhe gjithnjë e më shumë në media sociale). Nevoja për lajme dhe informacion në momente të caktuara shpesh përplasat me aftësinë e gazetarëve dhe mediave të besueshme me reputacion, të cilët kanë nevojë për kohë dhe përpjekje për të verifikuar faktet me shpejtësi dhe në situata të paparashikueshme. Ky tension midis dëshirës për informacion të menjëhershëm dhe realitetit të nevojshëm për të dhënë një informacion të saktë ka qenë veçoria karakteristike e peizazhit mediatik të sotëm, e theksuar veçanërisht në momente konflikti dhe në zonat e luftës. Veçori të cilën aktorët keqdashës e shfrytëzojnë për të manipuluar situatën dhe narrativat në interesin e tyre.



